



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0905

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Eor Group SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të KOMUNA - GJILAN në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Gjenerator” me numër të prokurimit 651-22-12442-1-1-1, me 10/01/2024, mori:

Vendim

1. **Anulohet** në tërësi aktiviteti i prokurimit “Furnizim me Gjenerator” me numër të prokurimit 651-22-12442-1-1-1 iniciuar nga Komuna Gjilan.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Eor Group SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Kuvendi Komunal Gjilan në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 16.11.2022 ka publikuar Njoftimin për Kontratë - B05, për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Gjenerator” me numër të prokurimit 651-22-12442-1-1-1. Ndërsa me datën 01.11.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi

vendimin e Autoritetit Kontraktues me te cilin ka njoftuar anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës - furnizim, vlera e parashikuar e kontratës 160,350.00€.

Me 05.11.2023 Eor Group SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 07.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 13.11.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga Eor Group SH.P.K., me nr. 905/23 lidhur me aktivitetin “Furnizim me Gjenerator” me numër të prokurimit 651-22-12442-1-1-1.

Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Eor Group SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) - Ankuesi pretendon se “Autoriteti Kontraktues në period prej 1 viti vazhdimisht e ka zvarritur lëndën duke favorizuar OE INFINIT SHPK i cili është OE i pa përgjegjshëm, dhe për kundër dy vendimeve të PSH të OSHP-së , Vendimet Nr. 790/22 dhe Nr. 0212/2023 te PSH të OSHP-së qe kanë qenë në favor të grupit të OE EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K. Autoritetit Kontraktues kur ju shterren të gjitha mundësit për ta shperblyer OE INFINIT fitues, shkel rend nenin 62 të ligjit dhe bën vepër penale duke marr vendim për anulimin e tenderit.”

Pretendimi i dytë (II) -Ankuesi pretendon se “Duke pas parasysh qe PSH i OSHP-së ka marrë vendimin e dytë me datën 21.07.2023 në ankesën e drejtuar nga grupi i OE EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K se vendimi është i bazuar dhe ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues lënda të kthehet në rivlerësim. Autoriteti Kontraktues pas këtij vendimit 0212/2023 duke pa se nuk ka mundësi të favorizoj dhe shpërblej me kontratë OE INFINIT e zvarrit lëndën dhe nuk sjell vendim konform kërkesës te PSH të OSHP-së qe të sjell vendim brenda afatit të kërkuar nga PSH i OSHP-së që në afat prej 10 ditëve siç është cekur në vendim: 2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarrë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.”

Pretendimi i tretë (III) - Ankuesi pretendon se “Autoriteti Kontraktues nga vendimi i pare datës: 08.12.2022, vazhdimisht shkel rënd neni 1, neni 7 dhe dispozitat e cekura në dy ankesat paraprake, po ne rastin e vendimit të datës 01.11.2023 bën shkelje të rënd edhe të nenit 62 paragrafi 2 dhe 2.1. kur tenton për interesa të individve apo grupi të individve të anuloi tenderin

në kundërshtim me neni 62 paragrafi 2 dhe 2.1, pasi që në këtë fazë Autoriteti Kontraktues nuk mund të anuloi tenderin kur grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K jemi të përgjegjshëm dhe brenda buxhetit të paraparë për këtë tender.”

Pretendimi i katert (IV) - Ankuesi pretendon se “Autoriteti Kontraktues kur jep arsyetimin e kundër ligjshëm dhe bënë vepër penale: se mjetet e parapara për këtë aktivitet të prokurimit janë shpenzuar dhe se e njëjta drejtori me nuk posedon mjete te lira financiare për këtë vit fiskal, kërkojmë nga PSH i OSHP-së të mos bie në lajthitjen e zyrtarëve të “korruptuar” të Autoritetit Kontraktues dhe shkelësit recidivist të ligjit, mirëpo PSH i OSHP-së të detyrojë Autoritetin Kontraktues të anuloi vendimin e datës 01.11.2023 dhe të detyroj Autoritetin Kontraktues të merr vendim konform dispozitave të LPP-së dhe të shpërblej grupin e OE-ve EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K. Kërkojmë të merret vendim meritore nga PSH i OSHP-së, ku është i bazuar në LPP dhe të shpërblehet me kontratë grupin e OE-ve EOR GROUP SHPK & CONTANTI GENERATORS SH.P.K, Sa i përket buxhetit zyrtaret Autoriteti Kontraktues për vazhdimin e aktivitetit do të sigurojë mjetet financiare qoftë këtë vit fiskal apo vitin e ardhshëm fiskal për aktivitetin. Bazuar në nenin 62 paragrafi 2 dhe 2.1, në këtë fazë Autoriteti Kontraktues nuk mundë të ndërpret aktivitetin e prokurimit.”

Pretendimi i pestë (V) – Ankuesi pretendon se “Autoriteti Kontraktues kur thotë me datën 27.11.2023 ka pranuar kërkesë nga Njesia Kërkuese Drejtoria e Arsimit që te bej anulimin e aktivitetit me titull: “Furnizimi me Gjenerator” dhe Nr. të Prokurimit “GL 651-22-12442-1-1-1” me arsyetimin se mjetet e parapara për këtë aktivitet të prokurimit janë shpenzuar dhe se e njëjta drejtori nuk posedon mjete te lira financiare për këtë vit fiskal dhe kërkon nga zyra e prokurimit te mos vazhdoj me tutje me këtë aktivitet. Kërkojmë nga PSH i OSHP-së të i tërhiqet licenca zyrtarit të Prokurimit konform dispozitave të LPP-së për shkak të shkeljeve të rënda të LPP-së që i ka bere zyrtari i Prokurimit kur nuk është marr vendimi nga AK-ja edhe pse PSH i OSHP-së kishte dhënë vendimin me 21.07.2023 dhe AK-ja pas 100 ditëve me datën 01.11.2023, ka marr vendim për anulim.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, Eor Group SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7 dhe 62 të LPP duke kërkuar që të aprovohet si e bazuar ankesa, të anulohet vendimi i AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 16/11/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 905/23, ndërsa me datë 23/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0905 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së, dhe rekomandon që lënda të kthehet në rishqyrtim.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues (duke paraqitur përgjigjet/argumentimet e tyre përmes sistemit e-prokurimi) ndërsa OE është pajtuar rreth rekomandimeve të ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet Eor Group SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0905 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti Shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit nga PSH (OSHP) janë nxjerr 2 (dy) vendime me numër: OSHP: Nr. 0212/2023 i publikuar me datën: 21/07/2023 që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të respektohen dispozitat ligjore nenit 59, 60 të LPP, të cituara në vendimin e OSHP. Dhe vendimi i PSH Nr. 790/22 i publikuar me datë: 24/03/2023 që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të respektohen dispozitat ligjore nenit 7 dhe neni 11. Bazuar në nenin 16 (Rastet e Unifikuara) pra janë përsëritur pretendimet ankimore të njëjta për palët në procedurë lidhur me lidhur me këto pretendime ankimore, ku objekt i kontekstit dhe palët janë të njëjta, për rastet ku janë shqyrtuar më parë si çështje të gjykuara “res judicata” sipas nenit 105.2.16 të LPP –së, andaj nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues. Gjithashtu eksperti shqyrtues sqaron si në vijim: është përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht komisionit të vlerësimit - ZPP që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP –së.

Është e rëndësishme të kemi një pasqyrë të qartë të analizës së fakteve dhe argumenteve të dokumentuara ku jam bazuar në platformën elektronike e-prokurimi. Bazuar në platformën elektronike e-prokurimi, kam zhvilluar një analizë të kujdesshme të procedurës së prokurimit për aktivitetin e prokurimit në fjalë. Në rrjedhën dhe analizën e kësaj procedure, nuk kam identifikuar prova dhe fakte konkrete që dëshmojnë mungesën e mjeteve financiare për këtë aktivitet. Kjo përfshinë edhe raportin e ri vlerësues të datës 01.11.2023. Mungesa e provave dhe fakteve për mungesën e mjeteve financiare nga AK, raporti ri vlerësues ka shqyrtuar mundësinë e mungesës së mjeteve financiare për aktivitetin e prokurimit në fjalë. Megjithatë, sipas analizës së ekspertit, nuk janë ofruar prova dhe fakte konkrete që mbështesin këtë rekomandim për anulim të procedurës.

Rekomandimi për anulimin në raport dhe Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ka një rekomandim për anulimin e aktivitetit të prokurimit në raportin e ri vlerësimit dhe Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe letrave standarde. Megjithatë, përkundër këtij rekomandimi, raportin e ri vlerësimit dhe Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe letrave standarde nuk ofron fakte dhe argumente të mjaftueshme që të mbështesin një vendim të tillë. Mungesa e fakteve të dokumentuar bën që ky rekomandim në raport dhe Njoftimi mbi

Vendimin e Autoritetit Kontraktues të jetë pa baze. (Rekomandim nga komisioni i ri vlerësimit gjendet në raportin e vlerësimit pjesa e Deklaratës në nr e faqes 6).

Duke theksuar se nuk janë prezantuar fakte dhe argumente të mjaftueshme lidhur me pretendimet për mungesën e mjeteve financiare dhe rekomandimin e Autoritetit Kontraktues (AK) për anulimin e procedurës në fjalë. Gjithashtu, theksohet se ky anulim nuk përputhet dhe nuk është në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (LPP), veçanërisht Nenin 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, si dhe Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, Nenin 43 që ka të bëjë me ndërprerjen e procedurave të prokurimit. Për këtë arsye, rekomandimi për anulim nuk ka baza të mjaftueshme ligjore dhe faktike për të mbështetur një vendim të tillë dhe për mendimin e ekspertit shqyrtues ky pretendim është i bazuar.

Eksperti Shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit raporti i Ri vlerësimit është përgatitur me 31.10.2023 dhe është nënshkruar me datë 01.11.2023 duke u bazuar në vendimin me Nr: OSHP: 2023/0212 paragrafi 2 Citoj: 2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP, po ashtu duke u bazuar në Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurim Publik neni 40, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve vërejmë pika 40.3 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Duke u bazuar në sqarimet e lartë përmendura është tejkualuar afati kohor prej 30 ditëve dhe në rastet e jashtë zakonshme 20 ditë dhe në këtë rast nuk është respektuar nga AK Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurim Publik neni 40, po ashtu nuk kemi hasur në platformën elektronike njoftim/arsyeje për vonës të ri vlerësimit, duke u bazuar në sqarimet e lartë përmendura pretendimet ankimore janë të bazuara dhe lënda të kthehet në ri vlerësim.

Në kuadër të pretendimeve ankimore, është vërejtur se OE (ankues) ka theksuar/potencuar se Autoriteti Kontraktues (AK) mund të ketë interesa të caktuara të individëve apo grupit të individëve në lidhje me këtë çështje. Është rëndësishme të theksohet se, për shkak të mungesës së kompetencës si ekspert në këtë fushë, nuk është e mundur të zhvillohet një analizë më tej mbi këtë aspekt në këtë kontekst.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale lëndën/ankesën e operatorit ekonomik ankues Eor Group SH.P.K., si dhe ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të njëjta për palët në procedurë me vendimin Nr. 0212/2023 i publikuar me datën: 21/07/2023 (lënda të kthehet në rivlerësim) dhe vendimi i PSH Nr. 790/22 i publikuar me datë: 24/03/2023 (lënda të kthehet në rivlerësim), andaj nuk janë trajtuar/shqyrtuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave,

konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se aktiviteti i prokurimit “Furnizim me Gjenerator” me numër të prokurimit 651-22-12442-1-1-1, është trajtuar me vendimin paraprak të OSHP Nr. 0212/2023 i publikuar me datën: 21/07/2023 që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të respektoj dispozitat ligjore nenin 59, 60 të LPP, dhe vendimin Nr. 790/22 i publikuar me datë: 24/03/2023 që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të respektoj dispozitat ligjore nenin 7 dhe neni 11 të LPP, dhe se ankesa edhe kësaj radhe do të duhet që konform Rregullores së Punës së OSHP-së konkretisht neni 16.2 të trajtohet si “Res Judicata”. Po ashtu neni 105 paragrafi 2.16 i LPP-së sqaron: *“Në rastet e përsëritura me të njëjtat pretendime ankimore, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, në rastet të cilat janë shqyrtuar më parë, Kryetari i Panelit Shqyrtues i trajton si çështje të gjykuara “res judicata”*. Por paneli shqyrtues tani sipas arsytimit të AK ka ndryshuar gjendja dhe është dashtur detyrimisht të anulohet procedura e prokurimit për shkak të mungesës së mjeteve.

Sipas njoftimit mbi vendimin e AK (B58), ky aktivitet i prokurimit është anuluar me arsyetimin se mjetet e parapara për këtë aktivitet të prokurimit janë shpenzuar dhe se e njëjta drejtori më nuk i posedon mjete të lira financiare për këtë vit fiskal dhe kërkon nga zyra e prokurimit që mos të vazhdoj më tutje me këtë aktivitet. Zyra e Prokurimit, duke u bazuar në informatat e cekura më lartë dhe në nenin 26 të LPP, ku në këtë rast i pamundësohet nënshkrimi i kësaj kontrate, merr vendim që në harmoni me nenin 62 të LPP pika 1.1 të bëjë anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Lidhur me këtë lëndë OSHP më dt. 04.01.2024, ju drejtohet zyrës së prokurimit me këtë email "Jemi në shqyrtim të ankesës me nr. të protokollit 2023/0905, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Gjenerator” me nr. të prokurimit: "651-22-12442-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA GJILAN, për të cilin aktivitet ju e keni publikuar vendimin me dt. 01.11.2022, cituar “mjetet e parapara për këtë aktivitet të Prokurimit janë shpenzuar dhe se e njëjta drejtori më nuk posedon mjete të lira financiare për këtë vit fiskal”. Pretendimet ankimore janë se nuk janë përmbushur kushtet e nenit 62 të LPP-së, sa I përket anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit. Andaj, ju lutem të na ofroni dëshmi se nuk keni mjete financiare për këtë aktivitet apo që nuk është në planin buxhetor të Komunës".

Zyra e Prokurimit në Komunën e Gjilanit përmes emailit të dt. 04.01.2024, deklaroi se "Ju njoftojmë se i njëjti projekt nuk ka planifikim në prokurim si dhe në buxhet për vitin 2024, ndërsa në shkresë është e potencuar edhe konfirmimi nga ZKF që mjetet janë shpenzuar dhe janë marë me vendime përmbarimore". Po ashtu, këtij emaili me attachment ju është bashkangjitur edhe një shkresë me komunikimet me zyrtar përgjegjës të autoritetit kontraktues përfshirë Drejtorinë e Arsimit si dhe Zyrtarin Kryesor Financiar ku kanë konfirmuar se për këtë aktivitet janë shpenzuar të gjitha mjete dhe janë ekzekutuar me vendime përmbarimore.

Andaj, si pasojë e gjendjes së krijuar, përgjegjësin e mban vetë autoriteti kontraktues edhe sa i përket përmbajtjes së të gjitha shkresave, ndërsa, PSh detyrimisht duhet ta lë në fuqi anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, sepse në të kundërtën do të bie ndesh me parimet dhe dispozitat e prokurimit publik dhe AK do të vinte në një gjendje ku do ta kishte të pamundur nënshkrimin e kontratës pa i pasur mjetet në dispozicion. Në

Sipas nenit 8.3 të RRUOPP, citat: *“Nëse AK është autoritet publik ose organizatë buxhetore ZKF do të siguroj që: a. Fondet janë alokuar; ose b. Fonde të mjaftueshme do të alokohen në vitin*

fiskal në fjalë. Kjo dispozitë do të përfshihet në kontratën publike.”

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe nevojat e tij/saj AK në rastin konkret të vendos për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe për këtë mbajnë përgjegjësi, bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Kthimi i një aktiviteti të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, dhe të prolongimi deri në pafundësi të aktivitetit të prokurimit, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi sikurse në pikën 3, të dispozitivit është marrë në kuptim të nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores së punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - Eor Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: